



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:227185

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05427745

P.nr.230/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në lëndën penale kundër të akuzuarit V. M, nga fshati G. K e K, për shkak të katër veprave penale “Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK-së), i akuzuar sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr. 2094/2022 të datës 28.10.2022, e parashtruar në gjykatë me datë 02.11.2022, PP/II.nr.1809/23 e datës 26.10.2023 e parashtruar në gjykatë me datën 31.10.2023, PP/II.nr.2053/23 e datës 13.11.2023, e parashtruar në gjykatë me datë 15.11.2023, dhe PP/II.nr. 1912/23 të datës 15.11.2023, e parashtruar në gjykatë me datë 20.11.2023, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 07.02.2024 në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Pejë, prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, dhe të akuzuarit, V. M, më datë 09.02.2024, murr dhe publikisht shpalli kurse me datë 08.03.2024 e përpiloj me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

Të akuzuarit V. M nga fshati G. K e K, i biri i H, dhe nënës A, e gjinisë Q, i lindur me datën në fshatin G, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i 3 fëmijëve, me profesion bujk, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

1. Në kohë të panjohur e në vazhdimësi gjerë me datë, në fshatin R. K-K, përmes mënyrave tjera, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe

shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që i pandehuri V. M, në shtëpinë e tij në vendin e lartcekur devijon energjinë elektrike, duke u lidhur jashtë njehsorit elektrik me shifrën, dhe energjia e shpenzuar përmes këtij kabulli nuk regjistrohet fare, për çka kompaninë KEDS e dëmton në vlerë prej 374.26 euro,

-Me çka ka kryer vepër penale “Vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314 par 1 të KPRK-së.

2. Nga data e pavërtetuar e gjerë me datë, në shtëpinë e tij në fshatin R. K-K, me qëllim që vetës t’i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës, nr.06/L-074, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga ana e zyrtarëve të K, është hasur që njehsori elektrik i shkyçur nga distanca ka pasur kyçje direkte apo lidhje në rrjetin elektrik jashtë njehsorit, ashtu që në mënyrë të pa autorizuar ka shpenzuar energji elektrike me aparatur të cekur si në proces verbal, me këtë veprim është anashkaluar njehsori elektrik me numër, (pikën matëse) e cila kishte për të matur shpenzim të energjisë së shpenzuar elektrike me ç’rast ndërmarrjes së dëmtuar K-divizioni në K i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 64.48 euro,

-Me çka ka kryer vepër penale “Vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314 par 1 të KPRK-së.

3. Në kohë të panjohur e në vazhdimësi gjerë me datë, në fshatin R K-K, përmes mënyrave tjera, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmangë pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që, i pandehuri në shtëpinë e tij në vendin e lartcekur, devijon energjinë elektrike, duke u lidhur jashtë njehsorit elektrik me shifrën, dhe energjia e shpenzuar përmes këtij kabulli nuk regjistrohet fare, për çka kompaninë K. e dëmton në vlerë prej 75.34 euro,

-Me çka ka kryer vepër penale “Vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314 par 1 të KPRK-së.

4. Më parë e deri me datë, në shtëpinë e tij në fshatin R, K e K, përmes mënyrave tjera siguron shërbime të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që, gjatë kontrolles nga zyrtarët e K, është hasur i kyçur direkt në rrjetin elektrik (jashtë pikës matëse), duke anashkaluar njehsorin elektrik nr....., me numër unik nr....., ku është konstatuar se i njëjti ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar duke i shkaktuar kompaninë K, dëmin në vlerë prej 199 euro,

-Me çka ka kryer vepër penale “Vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314 par 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42,46, 47, 48, 49, 69, 70, 76 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPPRK-së), të pandehurin e:

GJYKON

1. Për veprën penale të përshkruar në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës dy (2) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.
2. Për veprën penale të përshkruar në pikën e dytë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës dy (2) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.
3. Për veprën penale të përshkruar në pikën e tretë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës dy (2) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.
4. Për veprën penale të përshkruar në pikën e katër të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës dy (2) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Gjykata konform nenit 76, par. 1 dhe 2 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM UNIK BURGIM ME KUSHT

I. Ashtu që, të pandehurit i shqiptohet dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej dy (2) vite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

- Në të kundërtën, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim, ashtu që, do të shqiptohet dënimi për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.

II. I pandehuri lirohet në tersi nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.

III. E dëmtuara K, për realizimin e kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur katër aktakuza PP/II.nr. 2094/2022 të datës 28.10.2022, PP/II.nr.1809/2023 të datës 26.10.2023, PP/II.nr.2053/2023 të datës 13.11.2023, PP/II.nr.1912/2023 të datës 15.11.2023, kundër të akuzuarit V (H) M, nga

fshati G. K. e K, për shkak të katër veprave penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragraf 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 07.02.2024, ku me pëlqimin të palëve në procedurë konform nenit 35 të KPPRK-së, mori aktvendim që të bëhet bashkimi i lëndëve penale të evidentuara me numrat punues sipas evidencës së kësaj gjykate P.nr. 230/2022, P.nr.169/23, mP.nr.177/23 dhe P.nr.183/23, pasi që bëhet fjalë për të njëjtin të akuzuar, si dhe këtu i akuzuari akuzohet për të njëjtat vepra penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par 1 të KPRK-së, si dhe është e njëjta palë e dëmtuara, e kjo bëhet për hir të ekonomizimit dhe racionalitetit në procedurë, ashtu që kundër të akuzuarit V. M, do të udhëhiqet një procedurë gjyqësore, do të nxjerrët një aktgjykim dhe lënda penale do të evidencohet me numër punues P.nr.230/2022.

I akuzuari në shqyrtimin fillestar, pasi që më parë nga ana e gjykatës është njoftuar për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, ka deklaruar se në mënyrë vullnetare e pranoj fajësinë për të gjitha veprat penale që më vihen në barrë, jam i penduar thellë për veprat që kam kryer, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale. I pandehuri ka shtuar se kam qenë në K, që të lidhë kontratë për pagesën me rata por shumën mujore që ma kanë kërkuar ta paguajë prej 4000 euro dhe pamundësisë time për pagesë kam dështuar të lidhi marrëveshje, jam shfrytëzues i veteranit të cilat nuk më dalin as për nevojat personale, kam 3 fëmijë në shkollë, një e kam student, ndërsa 2 në shkollën e mesme, e gjithë kjo është pasojë e vështirësive ekonomike që kam, shtoj se nëse me krijohen sado pak mundësitë materiale do të lidhë marrëveshje për kompensim dëmi me të dëmtuarën.

Prokurori i shtetit sa i përket pranimit të fajësisë të bërë nga i akuzuari, ka deklaruar se pasi i pandehuri ka pranuar fajësinë për katër veprat penale që i vihen në barrë ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të tillë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës. I propozoj gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprat penale që i vihen në barrë dhe me rastin e marrjes së vendimit lidhur me dënim pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

I pandehuri i ka dorëzuar gjykatës dëshminë (kopjen) se është Veteran i Luftës me nr. i Brig. 113 me nr..... me nr. personal, dhe jeton nga këto të ardhura.

Meqenëse i akuzuari e ka pranuar në tërësi fajësinë për të gjitha veprat penale të cilat i vihet në barrë, Gjykata ka vërtetuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, përkatësisht vlerësoj se i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim i fajësisë është bërë në baza vullnetare dhe se ka mbështetje edhe në faktet dhe provat që i përmbajnë aktakuzat. Po ashtu ka vërtetuar se aktakuzat nuk përmbajnë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat

për hedhjen e aktakuzave apo të pushimit të procedurës penale të parapara me nenin 243 dhe 244 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, andaj edhe ia ka pranuar këtë pranim të fajësisë.

Gjykata ka analizuar edhe dispozitat e veprës penale të Vjedhja e shërbimeve, ku në nenin 314 paragraf 1 të KPRK-së, është parashikuar se sipas kësaj dispozite këtë formë të veprës e penale e kryen “Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.

Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lart cituara, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, konsumohen të gjitha tiparet e veprave penale të përshkruar si në të gjitha dispozitivet e këtij Aktgjykimi, për çka gjykata ka vendosur që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të Ligjit, më parë duke ia vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70 dhe 71 paragraf 1 nën paragraf 1.3 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti pranimin e fajësisë për të gjitha veprat penale të cilat i vihen në barrë, është penduar shumë për veprimet e veta, ka shpreh keqardhje të thellë, e cila ishte e dukshme edhe për gjykatën, po ashtu i njëjti ka shpreh gatishmëri për kompensim të dëmit ndaj të dëmtuarës, pastaj gjykata pati parasysh edhe mënyrën dhe rrethanat në të cilat po thuajse çdo herë i njëjti i ka kryer këto vepra penale. Ndërsa si rrethanë renduese gjeti dashjen për kryerjen e këtyre veprave penale.

Gjykata sipas bindjes së saj, vlerësoj se shqiptimi i dënimit unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës 2 vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale, është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të akuzuarit, të cilët do ta kuptoj rëndësinë e veprave penale të cilat i ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet

Duke u bazuar në nenin 453 par. 4 të KPPRK-së, gjykata e ka liruar nga pagesa e shpenzimeve të procedurës.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Udhëzimi i palëve të dëmtuara në kontest të rregullt civil është i bazuar në dispozitat e nenit 462

par 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata e përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.230/22 me datë 08.03.2024.

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.